

Denion Meidani

Denion Meidani ka kryer studimet e larta në Clark University në dy degë: atë të Shkenca Kompjuterike dhe atë të Qeverisjes dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare deri në nivel akreditimi Master Shkencor për të dyja këto degë. Gjithashtu, ka një Master në Diplomaci me përqëndrim në Ekonomi Ndërkombëtare nga Universiteti i Maltës si dhe një Master në Administrim Biznesi nga Universiteti Bocconi në Itali.

Denion Meidani ka punuar në disa poste te ndryshme në administratën shqiptare si :

Këshilltar i Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilltar i Prokurorit të Përgjithshëm, Drejtor i Përgjithshëm pranë Ministrisë së Ekonomisë, Zv. Drejtor i Përgjithshëm i Korporatës Energjitike Shqiptare, Drejtor i Antikontrabandës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, disa herë Drejtor i Kontrollit të Brendshëm pranë Ministrisë së Drejtësisë, Drejtor i Monitorimit, Kontrollit, dhe Inspektimit pranë Autoritetit të Kontrollit Elektronik dhe Postar dhe së fundmi Zv. Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Drejtor i Departamentit të Analizave dhe Aposteriorit.

Denion Meidani ka operuar dhe në sektorin privat për disa korporata si: SIGMA Vienna Insurance Group, KFC, PuntoPay Italia, Antenna Media Group, Ok! Magazine, Renault, etj.

Njohës i disa gjuhëve të huaja si : angleze, italiane, turke.